STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 13 nëntor 2012

DEPARTAMENTI I SHERBIMEVE FINANCIARE DO TE OFROJE NDIHME PER SIGURIMIN TE MERKUREN NE GERRITSEN BIÇ (GERRITSEN BEACH), BRUKLIN (BROOKLYN)

Përfaqësues të Departamentit në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve mbi sigurimin nga 9 e mëngjesit deri në 5 të pasdites, të mërkurën, 14 nëntor

Linja telefonike e stuhisë gjithashtu ka personel për të ndihmuar viktimat e stuhisë Sendi (Sandy)

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare, njoftoi se përfaqësues të Departamentit të Shërbimeve Financiare do të jenë në Gerritsen Biç (Gerritsen Beach) në Bruklin (Brooklyn) nga 9 e mëngjesit deri në 5 të pasdites, të mërkurën, 14 nëntor, për të ofruar ndihmë për pronarët e shtëpive, qiramarrësit dhe pronarët e bizneseve për çështje që kanë lidhje me sigurimin që rrjedhin nga dëmi i shkaktuar nga Sendi (Sandy).

Përfaqësues të Departamentit do të jenë në dispozicion për t'u takuar me banorë të zonës brenda në Qendrën e Lëvizshme të Komandës të agjencisë, e cila do të gjendet në Fushën Lleri Vigën (Larry Vegan Field) (pranë vendit të rimëkëmbjes të FEMA-s) në vendtakimin e Gerritsen Avenue dhe Cyrus Avenue në Gerritsen Biç (Gerritsen Beach).

Përfaqësues të Departamentit do të ndihmojnë banorët që të kontaktojnë me siguruesit e tyre nëse nuk kanë qënë në gjendje t'a bëjnë këtë dhe do t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me mbulimin e sigurimit të pronarëve të shtëpive, qiramarrësve dhe pronarëve të bizneseve.

Banorët që nuk janë në gjendje të shkojnë në Qendrën e Lëvizshme të Komandës inkurajohen që t'i telefonojnë linjës mbi stuhinë të Departamentit (800) 339-1759 e cila është e hapur tani 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Informacioni mbi sigurimin është gjithashtu i disponueshëm në faqen në internet të Departamentit, www.dfs.ny.gov.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian